



REPUBLIKA E SHQIPËRISË  
GJYKATA E POSAÇME E SHKALLËS SË PARË  
PËR KORRUPSIONIN DHE KRIMIN E ORGANIZUAR

NJOFTIM PËR MEDIAT

1. Kërkuesi **Jacob Douglass Dickson**, më datë **19.06.2024** Nr. Regj.Them. 379, ka paraqitur pranë Gjykatës së Posaçme të Shkallës së Parë për Korrupsionin dhe Krimin e Organizuar kërkesën penale me objekt: “Kërkohet konfirmimi i ndryshimit të adresës së banimit të personit nën hetim **Jacob Douglass Dickson**, ndaj të cilit Gjykata e Posaçme kundër Korrupsionit dhe Krimin të Organizuar ka caktuar masën e sigurimit “Arrest në shtëpi” parashikuar nga neni 237 i K.Pr.Penale.
2. Në përfundim të gjykimit, Gjykata e Posaçme e Shkallës së Parë për Korrupsionin dhe Krimin e Organizuar me trup gjykues të përbërë nga gjyqtari Erjon Çela, mbështetur në nenet 112, 237 të K.Pr.Penale, me vendimin Nr. 379, datë 25.06.2024, vendosi:
  1. Pranimin e kërkesës së kërkuesit (personit nën hetim) **Jacob Douglass Dickson**.
  2. Ndryshimin e adresës së banimit të kërkuesit (personit nën hetim) **Jacob Douglass Dickson** për qëndrimin e tij nën masën e sigurimit personal me karakter shtrëngues “Arrest në shtëpi”, e caktuar me vendimin nr. 58 datë 11.06.2024 të Gjykatës së Posaçme të Shkallës së Parë kundër Korrupsionin dhe Krimin e Organizuar si më poshtë: “Rr. Jordan Misja, Nd. 261, kryqëzimi me rr. Azem Galica, (afër shinave të trenit) Tiranë”.
  3. Urdhërohet Prokuroria e Posaçme kundër Korrupsionit dhe Krimin të Organizuar dhe policia gjyqësore për ekzekutimin e këtij vendimi.
  4. Përkthyesi zyrtar i gjuhës angleze z. Fation Kolldani të paguhet nga shteti sipas tarifave të miratuara me ligj.
  5. Kundër këtij vendimi mund të bëhet ankim brenda 5 (pesë) ditëve në Gjykatën e Posaçme të Apelit për Korrupsionin dhe Krimin e Organizuar, afat i cili fillon nga dita njoftimit të vendimit të gjykatës.

Tiranë më datë 25.06.2024

Gjykata e Posaçme e Shkallës së Parë për Korrupsionin dhe Krimin e Organizuar